



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



**PSH.nr.298/20**  
**309/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi z - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Graniti” SH.P.K-Suharekë si dhe ankesës së OE: NTSH “Delfina”-Malishevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “Mobelland” SH.P.K & NTP “Metali”- Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me inventar në shkollat e arsimit Parauniversitar”, me nr. të prok: “208-019-060-1-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë /MASHT/, më datën: 25.06.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.HEDHET** si e pa lejuar ankesa e operatorit ekonomik “Graniti” SH.P.K-Suharekë si dhe ankesa e OE: NTSH “Delfina”-Malishevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me inventar në shkollat e arsimit Parauniversitar”, me nr. të prok: “208-019-060-1-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë /MASHT/.

**II.VËRTETOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me inventar në shkollat e arsimit Parauniversitar”, me nr. të prok: “208-019-060-1-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë /MASHT/.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Graniti” SH.P.K-Suharekë, dhe ankesa e operatorit ekonomik ankues NTSH “Delfina”-Malishevë, hedhen si te pa lejuara, në pajtim me nenin 14 pika 1.5 të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatoreve ekonomik ankues iu kthehet tarifa e ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Graniti” SH.P.K-Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 13.05.2020 me nr.298/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me inventar në shkollat e arsimit Parauniversitar”, me nr. të prok: “208-019-060-1-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë /MASHT/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:1, 7, 59, 60, 64, 69 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues OE NTSH “Delfina”-Malishevë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 18.05.2020 me nr.309/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me inventar në shkollat e arsimit Parauniversitar”, me nr. të prok: “208-019-060-1-1-1”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë /MASHT/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet:1, 6, 7 dhe nenin 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 21.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore për lëndën 327/20.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt:08.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:



## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “GRANITI”

### Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e parë ankimorë, për inxhinierin e arkitekturës vlerësojmë se kjo është çështje e gjykuar e cila është vendosur me vendim të OSHP-së nr.896/19.

### Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin ankimorë se certifikata e numrit fiskal e partnerit Elbasan Alidemi është e vitit 2009 dhe për këtë arsye di njëjti duhet eliminuar, vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar, dhe se kjo nuk paraqet arsye për eliminim të OE.

### Përgjigje në Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin ankimorë se nuk duhen merren parasysh kontratat e OE fitues, me arsye se i njëjti është regjistruar si biznes në vitin 2018 përkatësisht 2019, vlerësojmë se edhe ky pretendim ankimorë është i pabazuar sepse këto kompani janë të regjistruara si biznese shumë më herët, dhe ndryshimi i certifikatës së regjistrimit është vazhdimësi e njëjtave biznese. Konkretisht OE Mobelland është themeluar në vitin 2004 ndërsa OE Elbasan Alidemi emri regtar Metali në vitin 2000, andaj vlerësojmë se gjitha kontratat e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë brenda periudhës kohore të përcaktuar në dosje nuk mund të refuzohen.

### Përgjigje në Pretendimin nr.4

Lidhur me pretendimin e OE se nuk ka ofruar çmimin me fjalë, vlerësojmë se kjo nuk mund të merret si arsye për eliminim të OE , andaj pretendimi ankimorë është i pabazuar.

### Përgjigje në Pretendimin nr.5

Pretendimi ankimorë se OE Elbasan Alidemi ka përdor vulë të vjetër, konsiderojmë se as kjo nuk është arsye për eliminim të OE.

### Përgjigje në Pretendimin nr.6

Lidhur me pretendimin se te afati liferimit ka nënshkruar njëri anëtar, sqarojmë se afati liferimit është vulosur nga lideri i grupit, i cili me marrëveshje bartë të drejtën për nënshkrim dhe vulosje të gjitha dokumenteve që nga dalin nga kjo procedurë e prokurimit, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

#### Përgjigje në Pretendimin nr.7

Lidhur me pretendimin ankimorë se kompania Mobelland ka ofruar një katalog që nuk është i saj, dhe se katalogu i ofruar shënon vetëm Mobil, sqarojmë se katalogu të cilin e konteston OE ankues, vërtetë është kopje e kualitetit të dobët ku në disa vende në shikim të parë nuk lexohet komplet emri Mobelland, mirëpo nëse shikojmë me kujdes, shihet se katalogu është i firmës Mobelland, dhe pjesa “Land” është më vështirë e lexueshme për sigurisht për shkak të dallimit të ngjyrave në logo të kësaj kompanie, ku pjesa Land e cila është e kuqe në printim bardh e zi është më vështirë e lexueshme, me gjithë atë shihet se nuk kemi të bëjmë me katalog të ndonjë kompanie tjetër. Andaj vlerësojmë se edhe ky pretendim ankimorë është i pabazuar. Provë: oferta e OE ankues – katalogu i gjetur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

#### Përgjigje në Pretendimin nr.8

Lidhur me pretendimin ankimorë se inxhinierët L.Beqiri dhe H.Shala nuk janë punëtor të OE dhe se nuk kanë kontrata pune me OE, sqarojmë se OE ka ofruar kontrata pune me kohë caktuar për dy këta persona.

#### Përgjigje në Pretendimin nr.9

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE nuk ka mesataren prej 20 punëtor në vit dhe se nuk e ka dëshmuar me vërtetim të ATK-së, sqarojmë se kërkesë e dosjes nuk ka qenë vërtetim i ATK-së por raport prej OE, dhe sipas deklaratave-raportëve të OE dhe ky kompanitë së bashku arrijnë mesataren prej 20 punëtor në vit, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

#### Përgjigje në Pretendimin nr.9

Lidhur me pretendimin ankimorë se te lista çmimeve nuk shihet specifikacioni teknik dhe se nuk është e vulosur dhe nënshkruar, sqarojmë se me gjithë se kualiteti i kopjes është i dobët, lista dhe specifikacionet me gjithë atë janë të lexueshme, e po ashtu është e nënshkruar në faqe të fundit, me gjithë në prokurim elektronik nuk do të paraqiste problem.

#### Përgjigje në Pretendimin nr.10

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE nuk i ka 1.5 milion euro kontrata për tri vitet e shkuara, sqarojmë se sipas listave të ofruara nga vet OE i rekomanduar për kontratë, edhe pasë eliminimit të kontratave që janë realizuar më herët se periudha e kërkuar në dosje, dhe pas eliminimit të kontratave të cilat janë ende në realizim e sipër, OE i rekomanduar për kontratë prapë arrin dhe tejkalon vlerën prej 1.5 milion sipas kërkesave të dosjes, dhe në rast se AK ka pas dyshim për vërtetësinë e ndonjë kontratë kanë mundur të kërkojnë sqarime prej OE, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.



#### Përgjigje në Pretendimin nr.11

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE nuk ka deklaratë të prodhuesit ndërsa nuk është prodhues i karrikave rotative dhe i ormanave metalik, sqarojmë se që dy partnerët janë të regjistruar si prodhues të karrigave apo inventarit të ndryshëm dhe eksperti sqhyrtues nuk ka kapacitet teknik të konstatoj një pretendim të tillë ankimorë.

#### Përgjigje në Pretendimin nr.12

Lidhur me pretendimin ankimorë se disa çmime të OE të rekomanduar për kontratë nuk janë të dukshme, vlerësojmë se kjo është çështje e gjykuar me vendim të OSHP-së nr.896/20, dhe me gjithë se kualiteti i kopjes është i dobët me gjithat gjitha çmimet e OE janë të lexueshme.

#### Përgjigje në Pretendimin nr.13

Lidhur me pretendimin ankimorë se nuk ka dhënë “asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim”, vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar, me gjithë këtë kthimi i lëndës në rivlerësim mbi bazën e këtij pretendimi ankimorë nuk do kishte ndikim në rezultat final të vlerësimit të ofertave.

### PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “DELFINA”

#### Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e parë ankimorë, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka për plotësuar kërkesën për QERTIFIKATË EN. 1729-1, 2015 EN 1729-2 2012+Al 2015, sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar së pari certifikatën EN.1729-1:2015 si dhe certifikatën EN 1729-2 2012+Al 2015, certifikata këto për prodhim të dyshekëve, ulëseve për një, dy dhe tre persona si dhe për karrige rotative. Me qenë se nuk ka pas kërkesë decidive nga AK se këto certifikata duhet të jenë për tavolina vlerësojmë certifikata ofruar është në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe pretendimi ankimorë është i pabazuar.

#### Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin ankimorë për çmime të padukshme, vlerësojmë se kjo është çështje e gjykuar me vendim të OSHP-së nr.896/19 , dhe me gjithë se kualiteti i kopjes është i dobët, me gjithë këtë çmimet e OE të rekomanduar janë të dukshme.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues Graniti të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ankesa e OE Delfina të refuzohet e pabazuar, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 11.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik NTSH “Delfina”-Malishevë, me datë: 10.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “Graniti” SHPK-Suharekë, me datë: 12.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesat janë parathuar kundër Njoftimit për dhenie të kontratës.

Paneli shqyrtues në vijim jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE “Graniti” SH.P.K-Suharekë

Lidhur me pretendimin e ankuesit për inxhinierin e arkitekturës. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se kjo është çështje e gjykuar e cila është vendosur me vendim të OSHP-së PSH. nr.896/19.

Lidhur me pretendimin ankimorë se certifikata e numrit fiskal e partnerit Elbasan Alidemi është e vitit 2009 dhe për këtë arsye i njëjti duhet eliminuar. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se pretendimi ankimorë është i pabazuar, dhe se kjo nuk paraqet arsye për eliminim të OE.



Lidhur me pretendimin ankimorë se nuk duhen merren parasysh kontratat e OE fitues, me arsye se i njëjti është regjistruar si biznes në vitin 2018 përkatësisht 2019. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se edhe ky pretendim ankimorë është i pabazuar sepse këto kompani janë të regjistruara si biznese shumë më herët, dhe ndryshimi i certifikatës së regjistrimit është vazhdimësi e njëjtave biznese. Konkretisht OE Mobelland është themeluar në vitin 2004 ndërsa OE Elbasan Alidemi emri tregtar Metali në vitin 2000, andaj vlerësojmë se gjitha kontratat e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë brenda periudhës kohore të përcaktuar në dosje nuk mund të refuzohen.

Lidhur me pretendimin e OE se nuk ka ofruar çmimin me fjalë. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kjo nuk mund të merret si arsye për eliminim të OE , andaj pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se edhe pretendimi i ankuesit lidhur me atë se OE Elbasan Alidemi ka përdor vulë të vjetër, është i pa qëndrueshëm dhe se kjo nuk mund të merret si arsye për eliminim të një operatori ekonomik OE.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se te afati liferimit ka nënshkruar njëri anëtar i OE të rekomanduar për dhënie të kontratës . Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se afati liferimit është vulosur nga lideri i grupit, i cili me marrëveshje bartë të drejtën për nënshkrim dhe vulosje të gjitha dokumenteve që dalin nga kjo procedurë e prokurimit, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimorë të OE ankues, se kompania Mobelland ka ofruar një katalog që nuk është i saj, dhe se katalogu i ofruar shënon vetëm Mobil. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se katalogu të cilin e konteston OE ankues, vërtetë është kopje e kualitetit të dobët ku në disa vende në shikim të parë nuk lexohet komplet emri Mobelland, mirëpo nëse shikojmë me kujdes, shihet se katalogu është i firmës Mobelland, dhe pjesa “Land” është më vështirë e lexueshme për sigurisht për shkak të dallimit të ngjyrave në logo të kësaj kompanie, ku pjesa Land e cila është e kuqe në printim bardh e zi është më vështirë e lexueshme, me gjithë atë shihet se nuk kemi të bëjmë me katalog të ndonjë kompanie tjetër. Andaj vlerësojmë se edhe ky pretendim ankimorë është i pabazuar. Provë: oferta e OE ankues – katalogu i gjetur në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Lidhur me pretendimin ankimorë të OE ankues, se inxhinierët L.Beqiri dhe H.Shala nuk janë punëtor të OE dhe se nuk kanë kontrata pune me OE. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se ky

pretendim është i pa bazuar për faktin se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar kontratë pa punë me kohë caktuar për dy këta persona.

Lidhur me pretendimin ankimorë të OE ankues, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka mesataren prej 20 punëtorë në vit dhe se nuk e ka dëshmuar me vërtetim të ATK-së. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se kërkesë e dosjes nuk ka qenë vërtetim i ATK-së por raport prej OE, dhe sipas deklaratave-raportëve të OE del se dy kompanitë së bashku arrijnë mesataren prej 20 punëtorë në vit, andaj konsiderojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimorë të OE ankues, se te lista çmimeve nuk shihet specifikacioni teknik dhe se nuk është e vërtetë dhe nënshkruar. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se me gjithë se kualiteti i kopjes është i dobët, lista dhe specifikacionet me gjithë atë janë të lexueshme, e po ashtu është e nënshkruar në faqe të fundit, me gjithë në prokurim elektronik nuk do të paraqiste problem.

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i ka 1.5 milion euro kontratë për tri vitet e shkuara. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se sipas listave të ofruara nga vet OE i rekomanduar për kontratë, edhe pas eliminimit të kontratave që janë realizuar më herët se periudha e kërkuar në dosje, dhe pas eliminimit të kontratave të cilat janë ende në realizim e sipër, OE i rekomanduar për kontratë prapë arrin dhe tejkalon vlerën prej 1.5 milion sipas kërkesave të dosjes, dhe në rast se AK ka pas dyshim për vërtetësinë e ndonjë kontratë kanë mundur të kërkojnë sqarime prej OE, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimorë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka deklaratë të prodhuesit ndërsa nuk është prodhues i karrikave rotative dhe i ormanëve metalik. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se që dy partnerët janë të regjistruar si prodhues të karrikave apo inventarit të ndryshëm, AK nuk mund të bëjë pranimin e materialit nëse materiali i ofruar nga OE nuk plotëson specifikacionet e FDT-së.

Lidhur me pretendimin ankimorë të ankuesit, se disa çmime të OE të rekomanduar për kontratë nuk janë të dukshme. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se kjo është çështje e gjykuar me vendim të OSHP-së nr.896/20, dhe se, edhe pse kualiteti i kopjes është i dobët mirepo gjitha çmimet e OE janë të lexueshme.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në konstatimet e cekura si më lart, ku shihet se asnjëri nga pretendimet ankimore të OE “Graniti” SH.P.K-Suharekë nuk është i qëndrueshëm si dhe duke marrë parasysh faktin se



OE ne fjale ne fazën ku aktiviteti i prokurimit ne fjale ishte anuluar nga autoriti kontraktues nuk kishte parashtruar fare ankese, vijmë ne përfundim se OE “Graniti” SH.P.K-Suharekë”, nuk ka arritur të dëshmoj interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues, ashtu siç parashihet ne nenin 4 par. 1 pika 26 të LPP-së, e të cilin thuhet: Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.

Paneli shqyrtues ne vijim jep konstatimet lidhur me pretendimet ankimore te “NTSH “Delfina”-Malishevë,”

Lidhur me pretendimin e ankuesit, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën për QERTIFIKATË EN. 1729-1, 2015 EN 1729-2 2012+Al 2015. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar së pari certifikatën EN.1729-1:2015 si dhe certifikatën EN 1729-2 2012+Al 2015, certifikata këto për prodhim të dyshekëve, ulëseve për një, dy dhe tre persona si dhe për karrige rotative. Me qenë se nuk ka pas kërkesë decidive nga AK se këto certifikata duhet të jenë për tavolina, konstatojm se certifikata ofruar është në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për çmime të padukshme nga OE i rekomanduar për dhënie te kontratës. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton, se kjo është çështje e gjykuar me vendim të OSHP-së nr.896/19 , edhe pse kualiteti i kopjes është i dobët, me gjithë këtë çmimet e OE të rekomanduar janë të dukshme.

Paneli shqyrtues duke u bazuar ne konstatimet e cekura si me lart , ku shihet se asnjëri nga pretendimet ankimore te OE “NTSH “Delfina”-Malishevë, nuk është i qëndrueshëm, vijmë në përfundim se OE “NTSH “Delfina”-Malishevë, nuk ka arritur të dëshmoj interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues, ashtu siç parashihet ne nenin 4 par. 1 pika 26 të LPP-së, e të cilin thuhet: Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka marr parasysh dhe ka

vepruar duke pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë dhe njëkohësisht autoriteti kontraktues ka marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit duke u siguruar që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i hedhur si te pa lejuara te dy ankesat e te dy operatoreve ekonomik ankues dhe duke e vertetuar vendimin e AK-së- Njoftimin për dhenie të kontratës,

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

#### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 AK- Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë /MASHT/
- 1x1 OE – “Graniti” SH.P.K-Suharekë dhe OE: NTSH “Delfina”-Malishevë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.